

ANILA SHORRI

ZHVILLIME SEMANTIKE TË GREQIZMAVE NË GJUHËN SHQIPE

Qëllimi i studimit

Objekt i këtij punimi është bërë shtresa e huazimeve greke të pranishme në leksikun e shqipes, ndërsa synimi ka të bëjë me shqyrtimin tërësor të greqizmeve në shqipë, për të parë vendin e tyre në leksikun e shqipes dhe sidomos për të vëzhguar zhvillimet semantike që kanë pësuar në shqipë.

Metodologjia e studimit

Për përgatitjen e këtij punimi është vjelë me kujdes shtresa leksikore e greqizmeve nga vepra "Studime gjuhësore" e profesor E. Çabejt dhe është vërejtur zhvillimi semantik i fjalëve të dala si huazime në veprën e mësipërme.

Nëpërmjet këtij punimi dalin në pah disa vëzhgime gjuhësore për shtresën e greqizmeve në shqipë, duke u përqendruar veçanërisht në zhvillimet semantike, të cilat janë me interes jo vetëm për shqipë, por edhe për greqishten.

Për përgatitjen e këtij punimi është vjelë me kujdes shtresa leksikore e greqizmeve nga vepra "Studime gjuhësore" e profesor E. Çabejt. Këto greqizma janë të përfshira në fusha të ndryshme leksikore si:

1. **detarisë:** *balladër, barbun, cfrat, levrek, pellg, remë,*
2. **bimësisë:** *ardhi, demet, fidhës, kodoriqe, kallomboq, kallm, kumbull, mendull, mullohë, okër, tërfojë, vasilikua,*
3. **fetare:** *bagëm, hienore, hir, krezm, ikonë, vajë,*
4. **blegtorisë:** *cangadhe, ftujë, gremeratë, vargër vërga,*
5. **mitologjisë:** *bajloz, djemën, kem qem, parajsë,*
6. **veglat e punës:** *drapër, dhimisiqi, dhiqel, dhokan, faqell,*
7. **mjekësisë:** *fausë,*
8. **farefisnisë:** *jajë,*
9. **jetës së përditshme:** *argsh, arratisem, balastri, bastun, caruqe, cinkë, cohë, cuks, drum, dhiglë, i egër, fagusë, falis, fanitet, faqol, fillikat, frangji, gjoni, holas, jerm, kamere, kanakar, kapasë, kothom, kurtinë, lavonj, lerë, lukuni, meteh, milak, ngastër, palëhuar, pat, pellas, përqi, radhë, shtamë, shtupë, vagjëli.*

Nga një vëzhgim i detajuar i këtyre fjalëve në "Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe", 1980 rezulton se fjalë të tilla si: *argsh, barbun, bigoni, cikofua, cuks, dreq, dhiqel, faqel, fanitet, fidhës, fillikat, fqollë, frat, franxhollë, jerm, kadoriqe, kallamboq, kandërr, kem, krusmë, krezm, leshkorre, mëllagë, mështekën, okër, patështinë, përqi, pjekë, shqind, e ndonjë tjetër, të jenë fjalë monosemantike, ndërsa të tjerat janë polisemantike. Për këto të fundit është*

analizuar tipologjia e zhvillimit kuptimor të tyre, pra cilat janë kuptimet e reja që kanë marrë këto fjalë e çështje të tjera gjatë rrugës, si p.sh. ndryshimet e kategorive morfologjike.

Konkretisht, fjalë të tilla si: **arëz, bagëm bajloz, cangadhe, demet, ftujë, furqetë, ikonë, kallume, kameri, kanakar, kapasë, kumbull, levrek, lukuni, milak, parajsë, pat, pezëm, shqemë** dalin me dy kuptime, madje në ndonjë rast janë përfshirë në ndërtimin e shprehjeve frazeologjike, si dhe kanë shërbyer si tema fjalëformuese për ndërtimin e fjalëve të reja.

Në kuptimet që pasqyrohen çdo fjalë, shpeshherë kemi edhe zgjerim të fushës semantike, që do të thotë se fjala e ka zgjeruar edhe më tej përdorimin e saj nga një fushë e kufizuar në një tjetër më përgjithësuese, siç është rasti i fjalës **parajsë**. Në të njëjtën kohë, nga fjalët e mësipërme nuk mungojnë as rastet ku kemi zgjerime të klasave të fjalëve, gjë që shtrin edhe më tej përdorimin e këtyre huazimeve në gjuhën tonë, si p.sh fjala **kanakar** (nga greqishtja është huazuar si mbiemër dhe gjatë përfshirjes në masë në shqipe, e gjejmë të shfaqur edhe si emër në ligjërimin bisedor).

Fjalët e mëposhtme, të pasqyruara në fjalor me tri kuptime: **arbër, bastun, bletë, dërhem, ngastër, sqimë**, kanë pësuar zhvillime të shumta semantike. Këto rikuptimesime të greqizmave në shqipe jo gjithmonë kanë lidhje me kuptimin e parë. Shpesh, ato e vazhdojnë shtrirjen e kuptimit duke u mbështetur në kuptimin paraardhës. Pra, këto kuptime nuk janë thjesht forma të ngurtësuar që duhet të ruajnë domosdoshmërisht lidhjet me fjalën burimore, por tregojnë se janë kthyer në pjesë të gjallë të gjuhës së folur dhe të shkruar të popullit.

Një veçori interesante në këtë grup ishte rasti i fjalës **arbër**, e cila në fjalor është pasqyruar si homonim dhe secila nga format është e pajisur me tri kuptime të veçanta. Po kështu, rasti i kuptimit të dytë të fjalës **bastun**, i pasqyruar në fjalor si terminologji e veterinarisë.

Fjala **pëllëmbë**, huazuar prej greqishtes së vjetër shfaqet me katër kuptime. Nga ballafaqimi i tyre mund të themi se lidhja e çdo kuptimi me paraardhësin bëhet sipas një lidhjeje zinxhir, që do të thotë se kuptimi i hershëm zhvillohet më tej në kuptimin e dytë, i dyti zgjeron më tej kuptimësinë në kuptimin e tretë e ky i fundit e zgjeron edhe më tej fushën semantike në kuptimin e katërt.

Me gjithë zhvillimet e shumta semantike nga kalimi i njërit kuptim në tjetrin, fjala pëllëmbë në rrafshin morfologjik mbetet e pandryshuar, pra ajo i përket klasës së emrave femërorë me përdorim si në njëjës, ashtu edhe në shumës. Ajo përket grupit të vjetër të huazimeve të shqipes nga greqishtja, ndaj është përshtatur kaq mirë në gjuhën shqipe, por jo vetëm kaq pasi kjo fjalë përdoret edhe në frazeologjinë letrare *pëllëmbë flor*, tokë shumë pjellore. *Shëtit me pëllëmbë*, e shëtit një vend skaj më skaj, e bredh anembanë etj. Dhe në të njëjtën kohë, ka shërbyer edhe si teme fjalëformuese për t'u formuar

fjalë të reja, sepse me bazë fjalën pëllëmbë, ne sot kemi; pëllëmbëgjërë, pëllëmborë, etj.

Fjalë si: **ngop** dhe **shtupë** janë pasqyruar me pesë kuptime.

Për të parën, ajo që vihet re nga ballafaqimi i kuptimeve dhe që ruhet në thelb të tyre, ka të bëjë me mbushjen, të dhënurit, të të ngrënit, të pirit etj., por në rrafsh të ndryshme kuptimore. Kuptimi i parë dhe i pestë, me kuptimin e parë, ndërsa tre të tjerët, të ndërmjetmit, me kuptimin abstrakt. Kjo fjalë ka shërbyer edhe si temë fjalëformuese për krijimin e fjalëve të reja në gjuhën shqipe, sepse sot me bazë fjalën ngop kemi ngopem, ngopje, ngopur.

Fjala **shtupë** në kuptimin e dytë ruan, në thelb, fushën e përdorimit nga kuptimi i parë, atë të mbushjes së diçkaje. Në kuptimin e tretë vërejmë se fjala terminologjizohet, pasi lënda me të cilën shtupohen birat e minave është pasqyrimi i kuptimit të saj në fjalor, është term në mineralogji, pra kuptimi shoqërohet me rrudhje të kuptimit leksikor të fjalës e, rrjedhimisht, me rrudhje të fushës së përdorimit. Në qoftë se ballafaqojmë kuptimin e parë me atë të katërt diçka e thatë, pa lëng dhe e ngjeshur; shuk mishi a i një ushqimi tjetër, që ka mbetur pa lëng nga të përtypurit e të mbajturit gjatë në gojë dhe nuk gëlltitet dot (shtupë djathi, mishi), vërejmë se largohet nga ana semantike dhe lidhja e re ka të bëjë me kuptimin e dytë. Në kuptimin e pestë të fjalës ka ndërrim të klasës, nga emër në përdorim mbiemëror, i thatë e ngjeshur e që mezi përtypet, zakonisht për disa ushqime që duhet të jenë të buta e me lëng (e paske bërë përsheshin shtupë), ndërsa nga ana kuptimore vërejmë se në krahasim me kuptimin e katërt, këtu ka zgjerim kuptimor.

Pra, nisur nga këta shembuj, kjo fjalë me pesë kuptime në fjalor, që ka pësuar një zhvillim të kuptimit të saj në pesë të tillë, përdoret në frazeologjinë letrare: *ia la shtupë, e ka bërë shtupë enësh, i ishte bërë zemra shtupë, ia kanë mbyllur gojën me shtupë*, etj., dhe në të njëjtën kohë ka shërbyer si temë fjalëformuese për fjalë të reja, sepse me bazë fjalën shtupë: sot kemi shtupim, shtupohet, shtupoj, shtuposur, shtupues, etj.

Fjalët **kallm** dhe **ja**, të huazuara prej greqishtes janë pasqyruar me gjashtë kuptime në fjalor. Nga ballafaqimi i kuptimeve vihet re se zgjerimi semantik, pasi në kuptimin e dytë përdoret me kuptim dëftor, kur zë fill tregimi, ligjërimi, etj.; kur ndryshon temën e bisedës ose kur duam të tërheqim vëmendjen për atë që do të themi (ja si ndodhi, ja ç'më shkruan, etj.), ndërsa në kuptimin e tretë përdoret kur shprehim nxitim, shpejtim, etj., afërsisht me kuptimin "menjëherë, tashti, këtë çast" (Ja tashti! Ja, vajta e erdha!). Fusha leksikore dhe ajo e përdorimit të kësaj fjale zhvillohet edhe më tej në kuptimin e katërt të fjalës përpara përemrave vetorë e dëftorë, si edhe përpara disa ndajfoljeve, me kuptimin: "pikërisht" (Ja, ai e shpëtoi. Ja, këtë desha të them). Në kuptimin e pestë përdoret për të shprehur qëndrimin e folësit ndaj asaj që dëgjon, që vë re, etj., zakonisht për të shprehur kënaqësi, habi, zemërim,

përçmim, etj. (Ja dhe puna jote. Ja ç'vete bën!). Në kuptimin e gjashtë, kjo fjalë përdoret me një parafjalë a me një lidhëz, kur përmbyllim një mendim, kur nisim të nxjerrim përfundimin, kur shpjegojmë arsyet e diçkaje, kur kumtojmë diçka me rëndësi ose kur fillojmë një numërim (Ja tek e solli fjalën). Kjo fjalë e ka zgjeruar së tepërmi kuptimësimin e saj në gjuhën shqipe, ndërsa në rrafshin morfologjik, në të gjashtë kuptimet e pasqyruara, ruan përkatësinë e saj në klasën e pjesëzave. Por fjala *ja* përdoret edhe për të krijuar njësinë frazeologjike *ja që hë* në kuptimin *s'ke ç'i bën, hë pra*, gjë që flet edhe njëherë qartazi se fjala e shqipes *ja*, e huazuar prej greqishtes, është përshtatur mjaft mirë në gjuhën shqipe duke marrë kuptime të reja dhe duke hapur në këtë mënyrë fusha të ndryshme semantike. Kjo fjalë trajtohet në homonimi në këtë fjalor, si lidhëz, por vetëm e përsëritur (ose...ose..., a...a...ja vdekje, ja liri)

Fjalët e poshtëpërmendura dalin me shtatë kuptime; **flori e lerë**

Kjo fjalë (flori), e huazuar nga greqishtja e re ka marrë një shumësi zhvillimesh semantike dhe morfologjike. Kjo flet qartë për mirëpërshtatjen në gjuhën shqipe. Kështu, duke kaluar nga njëri kuptim në tjetrin, fjala zgjeron fushën semantike, ndryshon klasën e saj nga emër në mbiemër e më pas ndajfolje, krijon kapërcime të tipit konkret në abstrakt, etj..

Fjala **lerë**, përveç zhvillimit të saj kuptimor, të cilin e zgjeron semantikisht me anë të rikuptimësimeve dhe ndryshimit të kategorisë leksikore nga njëjës në shumës, ruan në themel të kuptimeve fushën leksikore të të qenit i papastër, të të mbushurit me pisllek, një fushë leksikore, e cila, në fakt, qëndron edhe në themel të kuptimit të shtatë, edhe pse këtu kemi kapërcim klasor nga emër në ndajfolje tërë, krejt; kur dikush a diçka fëlliqet shumë (u bë lerë me gjak).

Duke iu referuar kuptimit të katërt, interesant është fakti se përdoret edhe në frazeologjinë letrare; *e bëri barkun lerë për piu shumë ujë, piu sa u fry*, dhe në të njëjtën kohë ka shërbyer edhe si temë fjalëformuese për të formuar fjalë të reja si leros, lerosëm, lerosur, etj...

Fjala **rrëfeje**, e huazuar prej greqishtes bizantine është pasqyruar me tetë kuptime në fjalor dhe është shoqëruar gjithmonë e më tepër me zgjerim të kuptimit leksikor, ndërsa nga pikëpamja e rrafshit morfologjik, fjala deri në kuptimin e gjashtë qëndron si folje kalimtare, ndërsa në kuptimin e shtatë dhe të tetë, përveçse zgjeron kuptimin leksikor të saj, pëson edhe kapërcime të rrafshit morfologjik duke u pasqyruar si folje jokalmimtare në kuptimin e shtatë dhe si folje pavetore në kuptimin e tetë. Me gjithë këto ndërrime të kategorisë leksikore, vetë klasa e fjalës nuk ndryshon. Fjala mbetet në klasën e foljes.

Shohim më nga afër këto kuptime 7) dukem; jap përshtypje nga pamja, është fjala këtu zakonisht për moshën (rrëfen i ri); 8) pavet. Tregojnë, thonë, flasin (rrëfejnë se ka bërë trimëri)

Kjo fjalë, me gjithë zhvillimet dhe kuptimet e reja të pasqyruara në fjalor, përdoret edhe në fushën e frazeologjisë letrare, p.sh: *ia rrëfeu qytetin dikujt, i*

tragon babait arat, si edhe shërben si temë fjalëformuese për krijimin e fjalëve të reja; rrëfim, rrëfyes, rrëfystore, etj.

Fjala **shkop**, e huazuar prej greqishtes së vjetër është pasqyruar me nëntë kuptime. Në gjashtë kuptimet e para, fjala **shkop** për nga kategoria leksikore që përfaqëson, mbetet në klasën e emrave pa kufizime e përdorime, ndërsa në kuptimin e shtatë, vërejmë se kjo fjalë pëson një rrudhje të kategorisë leksikore, pasi në këtë kuptim përdoret vetëm në numrin shumë *dy thupra të vogla që përdoren zakonisht në vendet e Azisë Juglindore për të ngrënë gjellë të ndryshme* (hanë oriz me shkopinj). Këtu ajo që shërben si urë lidhëse mes kuptimit të parë e të shtatë është pikërisht të qenit të drejtë e të hollë, që vihet re në kuptimin e parë.

Këtu mund të ekzistojë edhe një lidhje me kuptimin e tretë, atë të bastunit, por jo për t'u mbështetur që të mos rrëzohemi, por për të mbajtur ushqimin. Në kuptimin e nëntë, fjala shënon ndryshim të kategorisë leksikore-gramatikore; nga emër në mbiemër shumë i dobët nga trupi (ishte bërë shkop). Lidhja, në këtë rast, duhet kërkuar në kuptimin e parë një copë dru e hollë dhe e gjatë, por që në këtë kuptim, kemi abstraktim të fjalës dhe në të njëjtën kohë zgjerim të fushës semantike. Po në kuptim abstrakt, kjo fjalë është përdorur edhe në kuptimin e tetë, i cili paraqitet me nota negative në fjalor njeri i trashë nga mendja, hu (është shkop ai). Fjala shkop shërben edhe për të ndërtuar shprehje frazeologjike: *u bë për shkop*. S'ia ha qeni shkopin, etj., të cilat, pa dyshim, e zgjerojnë kuptimësinë e fjalës, por shërben edhe si temë fjalëformuese për krijimin e fjalëve të reja; shkopsis, shkopath, etj.

Fjala **pellg**, e huazuar prej greqishtes së vjetër është pasqyruar me dhjetë kuptime në shqipe, jo vetëm kuptimet që paraqet në fjalor, por edhe për larminë e fushave semantike që përfshin brenda saj. Nga kuptimi i parë, fjala paraqitet si konkrete, ndërsa në shtatë kuptimet e tjera merr zhvillime kuptimore abstrakte. Përveç zhvillimeve të mësipërme, fjala pellg shërben për të ndërtuar edhe njësi të ndryshme frazeologjike si: *u bë pellg në ujë, mbeti si guri në mes të pellgut*, etj., si dhe shërben si temë fjalëformuese për krijimin e fjalëve të reja: pellgaçe, pellgishte, pellgore.

Fjala **keq, i keq**, e huazuar prej greqishtes së vjetër, është pasqyruar me njëmbëdhjetë kuptime. Deri në kuptimin e dhjetë, fjala i përket klasës së mbiemrave, ndërsa në kuptimin e njëmbëdhjetë të pasqyruar në fjalor, sipas kuptimit të pestë dhe të gjashtë, kuptimi i ri i fjalës shoqërohet me ndryshim të kategorisë leksikore e gramatikore të fjalës nga mbiemër në emër. Ky padyshim është një pasqyrim edhe më i plotë i mirëpërshtatjes së kësaj fjale të huazuar nga greqishtja në gjuhën shqipe. Nuk është vetëm ky pohim në të mirë të asaj që u tha më lart, por dhe të trajtuarit e fjalës në homonimi, po kështu edhe si pjesë përbërëse e frazeologjisë letrare: Pa gjë të keqe. Janë parë me hënë të keqe, etj., dhe së fundmi duke shërbyer si temë fjalëformuese, pasi

përdoret si bazë për t'u krijuar fjalë të reja; keqadministrim, keqardhje, keqas, keqpësim, keqbërës, keqdashës, keqësim, etj..

Fjala **radhë**, e huazuar prej greqishtes së re, është pasqyruar me trembëdhjetë kuptime; në kuptimin e parë, të dytë, të tretë, të katërt, të pestë e të nëntë kuptimi i fjalës **radhë** nuk ndryshon në drejtim të kategorisë leksiko-gramatikore të fjalës, por në drejtim të fushës leksikore semantike, sepse në kuptimin e tretë bëhet fjalë për një brez apo një shtresë sendesh të vëna në një vijë njëri pranë tjetrit, një sërë tullash në një mur, një varg fijesh në diçka të thurur etj., në kuptimin e katërt bëhet fjalë për varg karrigesh për t'u ulur në kinema, në teatër, në një sallë ose në një mjet udhëtimi; varg bankash në një klasë, ndërsa në kuptimin e pestë varg fjalësh, shkronjash ose shenjash të tjera të shkruara në një vijë me dorë ose të shtypura në një faqe; varg shkronjash të renditura në shtypshkronjë për t'i shtypur; rresht. Në kuptimin e nëntë bëhet fjalë për një numër të pacaktuar njerëzish, sendesh, dukurish, një sasi jo e madhe, një varg. Në kuptimin e gjashtë të pasqyruar në fjalor, përdorimi i saj është kryesisht në numrin njëjës, që do të thotë se fjala e rrudh përdorimin e saj. Këtu është fjala për rresht njerëzish që presin për të dhënë a për të marrë diçka ose për një punë tjetër (zë radhën, ka radhë). Rrudhje të përdorimit të fjalës radhë janë vërejtur edhe në dy kuptime të tjera pasuese, në kuptimin e shatë dhe të tetë, pasqyruar në fjalorin e 1980-ës. Në të dyja këto raste është vërejtur se fjala shoqërohet me rrudhje të fushës semantike, sepse përdorimi i saj është vetëm në kuptimin e figurshëm. Kuptimi i shatë është më i kufizuar, sepse bëhet fjalë vetëm për numrin shumës; *tërësi njerëzish, që janë të lidhur ngushtë nga interesa e marrëdhënie të përbashkëta ose që bëjnë pjesë në një organizatë, në një parti, mjedis shoqëror etj.*, ndërsa në kuptimin e tetë fjala e zgjeron disi fushën e përdorimit, edhe pse brenda ligjërimit të figurshëm bisedor: *shtresë ose grup njerëzish, që kanë tipare të përbashkëta ose gjendje shoqërore të njëjtë, serë*.

Në kuptimin e dhjetë dhe njëmbëdhjetë, fjala *radhë* ka zhvillim kuptimi, referuar në kuptimin e dytë të saj, në fjalor. Bëhet fjalë pikërisht për ruajtjen në thelb të një rregulli, rendi a logjike, i cili në kuptimin e dhjetë pasqyrohet në këtë mënyrë; *rendi a rregulli sipas të cilit bëhet diçka, vijueshmëria në një mënyrë të caktuar për të kryer një veprim; vendi në këtë rend ose vijueshmëri, që i përket dikujt për të vepruar, ndërsa në kuptimin tjetër vërejmë vijueshmëri pa ndërprerje (për periudhat e kohës)*.

Pra, vërejmë se fjala radhë në këtë kuptim rrudhet, për sa i përket përdorimit, por në të njëjtën kohë, zgjerohet semantika e fjalës. Në të dymbëdhjetë këto kuptime, fjala radhë ruan kategorinë leksiko-gramatikore, ndërsa në kuptimin vijues, atë të trembëdhjetë, ajo ndryshon klasë duke kaluar në atë të ndajfoljes radhazi; *filloi radhë, ha radhë*.

Që fjala radhë ka përdorim të dendur në gjuhën shqipe nuk e dëshmon vetëm polisemia e saj, por edhe gjetja në frazeologjinë letrare. Ja disa nga

përdorimet e saj; *Në radhë të parë. Radhë e pa radhë. Sa për të shkuar radhën. Vihem në një radhë me dikë. Lexoj në mes të radhëve* etj. Dhe, siç vihet re nga të gjithë këta shembuj, kjo fjalë ka pësuar zhvillim kuptimi në trembëdhjetë të tilla, përdoret në shprehje frazeologjike dhe në të njëjtën kohë shërben edhe si temë fjalëformuese për t'u formuar fjalë të reja, sepse me bazë fjalën *radhë* ne kemi sot *radhë-radhë, radhim, radhit, radhitem, radhitës, radhoj* etj.

Përfundime

Nga shembujt e mësipërm, vihet re se fjalët e huazuara të shqipes nga greqishtja, duke kaluar nga një periudhë në tjetrën brenda zhvillimeve gjuhësore të shqipes, kanë pësuar zhvillime interesante dhe janë përshtatur mjaft mirë, edhe pse burimi i tyre është i huaj. Kështu, konkludohet se:

1- Shtresa leksikore e greqizmave, e vjelë dhe e analizuar në veprën “Studime gjuhësore” u përket fushave të ndryshme leksikore dhe terminologjive të ndryshme (bastun, rrëfej, pellg, keq, shtupë etj.)

2- Numri i huazimeve të vjela kap shifrën 135

3- Pjesa më madhe e greqizmave që janë futur në shqipe kanë prodhuar kuptime të tjera. Një pjesë e mirë e fjalëve polisemantike i kanë zhvilluar kuptimet e tyre të reja ose sipas lidhjesh zinxhir, ose duke iu referuar dhe zgjeruar, në të njëjtën kohë, fushën semantike të kuptimit të pare (ngop).

4- Një pjesë e këtyre fjalëve janë zhvilluar duke ruajtur të njëjtën kategori gramatikore (pëllëmbë), por ka edhe nga ato fjalë që kanë ndryshuar kategori duke iu referuar një kuptimi të caktuar (*keq*).

Me dëshirën e mirë që kjo analizë të jetë më e konkretizuar në studime të mëtejshme, shpresojmë që së shpejti të sjellim një studim të hollësishëm, tashmë për “*vendin e huazimeve greke në fjalorët shpjegues të gjuhës shqipe*”

BIBLIOGRAFI

- E. Çabej, *Hyrje në historinë e gjuhës shqipe*, Tiranë, 1958.
E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes I*, Tiranë, 1982.
E. Çabej, *Studime etimologjike në fushë të shqipes II*, Tiranë, 1982.
E. Çabej, *Studime gjuhësore I*, Prishtinë, 1954.
E. Çabej, *Studime gjuhësore II*, Prishtinë, 1954.
Fjalor i gjuhës së sotme shqipe, 1980.
J. Thomai, *Leksikologjia e gjuhës shqipe*, Tiranë, 2006.
J. Thomai, *Prejardhja kuptimore*, Tiranë, 1989.
Sh. Demiraj, *Gjuha shqipe dhe historia e saj*, Tiranë, 1988.
Sh. Demiraj, *Gjuhësi ballkanike*, Shkup, 1994.

